



Prishtinë, 26.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1214_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 9 të Kodit të Rrjetit- Dispozitat e përgjithshme,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derogimeve të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST të datës 18.12.2019 të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT),

në seancën e mbajtur me datë 26.12.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për **Derogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST** si në shtojcën e këtij vendimi.
- II. Dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbesin në fuqi.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 26.12.2019 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit Kodit i Matjes, Rregullat të Tregut dhe Licenca e OST.

❖ **Kodi i Rrjetit:**

➤ **Kodi i Planifikimit Operativ**

Penaqesat e sistemit të transmetimit, Kërkesat për rezerva, Kapacitetet interkonektive,
nuk mund të realizohen deri sa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese. Për këto



arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 30.06.2020;

➤ **Kodi i Balancit**

Dispecimi në kohë reale, Aranzhimet balancuese, nuk mund të realizohen deri sa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 30.06.2020;

Mospërputhja e ngarkesës me ajenerimin në kohë reale - nuk mund të realizohen në pjesën veriore të vendit deri sa të zgjidhet çështja e furnizimit të këtij rajoni. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 30.06.2020;

Rregullimin kohor - nuk mund të realizohen deri sa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 30.06.2020;

➤ **Kodi operativ**

Reduktimi nga nënfrekuenca, - nuk mund të realizohen në pjesën veriore të vendit deri sa të zgjidhet çështja e furnizimit të këtij rajoni. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

Testimi i startimit nga errësira dhe Testimet e sistemit - nuk mund të realizohen sepse nuk mund të sigurohet puna në "ilotazhë" e njësisve gjeneruese të KEK-ut por edhe nuk ka marrëveshje me OST tjera për simulim të startimit nga errësira. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

❖ **Kodi i Matjes**

Matjet e kapacitetit (fuqisë) dhe energjisë – Kriteri për njehsor nuk plotësohet për linjën interkonektive L 155/2 NS Vallaç – NS N. Pazar dhe grupet matëse të cilat nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas Kodit të Matjes janë:

- Dy pika matëse 35kV për TR1 dhe TR2 në NS Vallaçi,
- Dy pikat matëse 110kV për G1 dhe G2 në HC Ujmani, si dhe
- Një pikë matëse 35kV për NS Zubin Potok,

(Për të gjitha këto pika kërkohet derogim edhe së paku 1 vit, duke shpresuar se do të krijohen kushtet për investime gjatë vitit 2020);

Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

❖ **Rregullat Tregut**



Alokimi dhe tregtimi i kapaciteteve interkonektive KOSTT është aksionarë në SEE CAO dhe do ta shfrytëzojë atë si agjent në kryerjen e obligimeve që kanë të bëjnë me ankandin, alokimin dhe transferin e të drejtave të transferit fizik. Shërbimet nga CAO nuk mund ti shfrytëzojë ende pasi që ende nuk është implementuar Marrëveshja për Kyçje me ENTSO-E;

Nominimet interkonektive - Obligimet nga kjo dispozitë ndërlidhen me obligimet për Alokimin dhe Tregtimin e Kapaciteteve Interkonektive sipas Nenit 7 të Rregullave të Tregut. Obligim i njëjte është po ashtu në Nenin 16, paragrafi 1 (Interkonektorët) i Licencës së OST (OST bënë alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive me sistemet tjera në harmoni me procedurat e qarta dhe transparente për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave interkonektive).

Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin për këto pika deri me datë 30.06.2020;

❖ Licenca e OST

Disponueshmëria dhe mirëmbajtja e të dhënave – Derisa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese, nuk mund të bëhet publikimi i të dhënave për: Kapacitetet ndërkufitare, Funkionimin e interkonektorëve, si dhe Menaxhimin e kongjestionëve. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin për të dy pikat deri me datë 30.06.2020;

Blerja ekonomike e aseteve, shërbimeve dhe shërbimeve ndihmëse - KOSTT është duke blerë energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe energjisë balancuese nga KEK ndërsa për pjesën e pa mbuluar të humbjeve, blihet energjia elektrike në Ankandet ditore të organizuara nga OT. Marrëveshje Shërbimi për Ofrimin e Shërbimeve të Rregullimit Sekondar është e nënshkruar me OST, e cila është në fuqi, ndërsa implementimi i plotë i saj do të jetë efektiv vetëm në datën kur të gjitha kushtet e specifikuar në këtë Marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht.

Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin për të dy pikat deri me datë 30.06.2020;

Obligimi i sigurimit - KOSTT është për përmbushjen e këtyre obligimeve, dhe në bazë të kësaj do të përgatitet dokumentacioni për publikim të tenderit për sigurim të aseteve. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin për të dy pikat deri me datë 31.12.2020;

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës sipas Raportit të Derogimeve të dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.



III. Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rusniti, anëtar

Vendimi së bashku me Raportin e derogimeve me afatet e lejuara iu dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.